



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-104

Prishtinë, më 18 maj 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TËMBAJTUR MË 18 MAJ 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Slllobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Safete Hadërgjonaj, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli dhe Petar Miletqi;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Presidentit: Lumnije Murati
Nga ICO, Blerta Bejtullahu dhe
Nga OSBE, Florian Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe katër pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë

R e n d t e d i t ë s

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 maj 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 maj 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 6 maj 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, **vendosi** që seanca e ardhshme plenare e Kuvendit të mbahet më 27 maj 2010, me këtë

R e n d d i t e:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit i seancës së mëparshme,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Harmonizimi i nenit 47 të Rregullores së Kuvendit,
5. Votimi për Raportin e Agjencisë së privatizimit,
6. Votimi për Programin e Qeverisë së Kosovës për barazi gjinore,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ripranim,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e natyrës,
12. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2009,

13. Shqyrtimi i Raportit tëpunës së Komisionit të Konkurrencës, për vitin 2009,
14. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit ad-hoc për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media,
15. Propozimet e grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare të Kuvendit.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Shqyrtimi i Raportit të Radio Televizionit të Kosovës, për vitin 2009

Kryesia, lidhur me raportin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal e Media dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike që ta shqyrtojnë Raportin e Bordit të Radio Televizionit të Kosovës, Pasqyrat financiare, si dhe Raportin e auditorëve të pavarur, për vitin 2009, dhe Kuvendit t’ia paraqesin Raportin me rekomandime.

3.2 Shqyrtimi i Raportit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për pasqyrat e audituara për vitin 2009

Kryesia, lidhur me raportin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike që t’i shqyrtojë Pasqyrat e audituara të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2009, dhe Kuvendit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.3 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për shpenzimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2009

Kryesia, pasi shqyrtoi Rekomandimin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Miratohen Rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin për shpenzimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2009.
2. Kryesia mbështet propozimin për ndërtimin e përbashkët të Qendrës Administrative Protokollare “Gërmia, në Prishtinë, me bashkëfinancim të Kuvendit, të Presidencës dhe të Qeverisë së Kosovës, për të cilën duhet të vendos seanca plenare.

3. Në Planifikimet afatmesme buxhetore 2011-2013, në kuadër të Buxhet të Kuvendit të krijohet Programi i ri (kod) “Stafi mbështetës politik”, si dhe të krijohen kushte – hapësira pune për deputetët e Kuvendit.

3.4 Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për përzgjedhjen e Auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, për vitin 2008 dhe 2009.

Kryesia, lidhur me raportin e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Anulohen aktivitetet për përzgjedhjen e Auditorit të jashtëm për auditimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për shkak të numrit të pamjaftueshëm të ofertuesve të përgjegjshëm.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit - Shërbimi i Prokurimit që në afatin ligjor ta rishpall ftesën për tender.

3.5 Shqyrtimi i ftesës së Asamblesë Evropiane për Siguri

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar kryetarit të Komisionit për Punë të Jashtme, Sabri Hamiti, në Parlamentin e Republikës së Kroacisë, prej 16-19 maj 2010.
2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, të qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurit sipas paragrafit një (1) përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë, nr. 03-V-094.

3.6 Shqyrtimi i ftesës së Parlamentit të Sllovenisë

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa, në këtë përbërje: Gani Koci, Naser Osmani, Kosara Nikoliq, Safete Hadergonaj, Shkumbin Demaliaj dhe Besa Gaxherri, si dhe nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Shaban Selimi, Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj dhe Dashurie Canolli në Parlamentin e Sllovenisë, prej 19-22 maj 2010.
2. Shpenzimet e udhëtimit, të qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurit sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë, nr. 03-V-094.

3.7 Shqyrtimi i ftesës së Parlamentit të Finlandës

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në këtë përbërje: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Naser Rugova, Ibrahim Makolli, Radmila Vujoviq, Gjylnaze Syla, Mimoza Ahmetaj, Vezira Emrush dhe Xhezair Murati, në Parlamentin e Finlandës, prej 24-29 maj 2010.
2. Shpenzimet e udhëtimit, të qëndrimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurit sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë, nr. 03-V-094.

3.8 Shqyrtimi i ftesës së Kuvendit të Shqipërisë

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i pesë anëtarëve të Komisionit për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport në përbërje prej pesë (5) deputetëve në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, prej 24-26 maj 2010.
2. Shpenzimet e udhëtimit, të qëndrimit dhe të akomodimit sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë, nr. 03-V-094.

3.9 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit ad-hok për kompensim për angazhim shtesë

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet kompensimi i anëtarëve të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, në shumën prej 50 €, ndërsa 30 € për stafin mbështetës të komisionit, për çdo mbledhje të mbajtur.
2. Kompensimi, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, realizohet sipas evidencës së pjesëmarrjes në mbledhje.

3.10 Njoftimi i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për formimin e Nënkomisionit për hartimin e Projektligjit për privatizimin e ndërmarrjeve publike

Kryesia, pasi u njoftua me nismën e komisionit, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion mund ta formojë Nënkomisionin për hartimin e Projektligjit për privatizimin e ndërmarrjeve publike.

3.11 Njoftimi i anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për shkëputjen e njëanshme të marrëdhënies së punës me Kuvendin e Kosovës

Kryesia, pasi u njoftua me vendimin e anëtarit të OSHP-së, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të iniciojë procedurën për propozimin e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

3.12 Propozimet e Grupit Parlamentar të PDK-së, të LDK-së dhe të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryesia, pasi u njoftua me propozimet e grupeve parlamentare, të cekura më lart, vendosi që ato t'i procedojë në seancë plenare, më 27 maj 2010.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën 11:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale